

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Prill 2009 Nr. 24. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

QEVERISJA TOLERANTE E PERANDORISE OSMANE NE PALESTINE

Në vitin 1514, sulltan Selimi mori Jerusalemin dhe zonën përreth tij dhe kë-shtu nisën 400 vitet e qe-verisjes osmane në Palesti-në. Sikurse edhe në hapësirat e tjera te Pere-ndorise Osmane, kjo periudhë do t'i krijonte mundësinë Palestinës që të gëzonte paqe, stabilitet dhe të njihje bashkëjetesën har-monike të besimeve të ndryshme. Toleranca Islame vazhdoi në Perandorinë Osmane. Kisha, sinagoga dhe xhamia bashkëjetuan në paqe. Perandoria Osmane administrohej nën atë që njihet si "sistemi i kombit (miletit)", ku tipari themelor i saj ishte që popujt lejoheshin të jetonin sipas besimeve të tyre edhe sipas sistemeve të veta ligjore. Të krishterët dhe çifutët, të përshkruar si 'Ithtarë të Librit' në Kuran, gjetën tolerancë, siguri e liri në Perandorinë Osmane. Arsyeja më e rëndësishme për këtë ishte që, megjithëse Perandoria Osmane ishte një shtet Islamik e qeverisur nga myslimanët, ajo nuk dëshironte t'i detyronte qytetarët e saj me forcë që të pranonin Islamin. Përkundrazi, shteti osman synonte të ofronte paqe e siguri për jomuslimanët dhe t'i qeveriste ata në një mënyrë të tillë që ata të ndjeheshin të kënaqur me qeverisjen dhe drejtësinë Islamike. Shtete të tjera të mëdha të asaj kohe kishin mënyra qeverisjeje shumë të ashpra, shtypëse e jo-tolerante. Mbretëria e Spanjës nuk mund të toleronte ekzistencën e myslimanëve dhe të çifutëve në gadishullin spanjoll dhe ushtroi një dhunë të jashtëzakonshme ndaj këtyre dy bashkësive. Në shumë vende të tjera evropiane, çifutët ishin të shtypur vetëm për shkak se ishin çifutë (për shembull, ata u burgosën nëpër geto) dhe u bënë shpesh vik-tima të masakrave masive (pogromeve). Të krishterët nuk arrinin të shkonin mirë as me njëri-tjetrin. Luftërat mes protestantëve dhe katolikëve në shekujt XVI dhe XVII e shndër-rruan Evropën në një pellg gjaku. Lufta 30 vjeçare mes viteve 1618 dhe 1648 ishte paso-jë e mosmarrëveshjeve katolike-protestante. Si rezultat i kësaj lufte, Evropa Qendrore u shndërrua në fushëbeteje dhe vetëm në Gjermani, u vra një e treta e popullsisë 15 milionëshe. Në kushte të tilla, është e vërtet e rëndësishme e pamohueshme se qeverisja os-mane ishte tejet njerëzore. Shumë historianë dhe analiste politikë kanë tërhequr vëmend-jen te ky fakt. Një nga ata është eksperti i njohur i çështjeve të Lindjes së Mesme në Universitetin Kolumbian, Eduard Said. Ai e ka prejardhjen nga një familje e krishterë prej Jerusalemi dhe merret me punë kërkim-ore në universitetet amerikane. Në një intervistë për gazetën izraelite "Ha'aretz" ai rekomandoi "sistemin kombëtar osman", nëse do të ndërtohet një paqe e qëndrueshme në Lindjen e Mesme. Ajo çfarë ai tha është se një pakicë çifute mund të mbijetojë në të



njëjtën mënyrë që kanë mbijetuar në botën arabe të gjitha pakicat e tjera nën Perandori-në Osmane, me sistemin e milletit sepse kjo funksionoi shumë mirë. Ajo që kishin ata atëherë duket shumë më njerëzore nga kjo që kemi tani. (6) Arsyeja themelore për vend-osjen e qeverisjes tejet tolerante, të drejtë dhe humane në Perandorisë Osmane dhe të shteteve tjera myslimane është se qeveri-te tilla udhëhiqeshin dhe udhëhiqen sipas Kuranit. Arsyeja për beshtetjen e drejtësisë dhe të qytetërimit nga ana e Omerit, Sala-hudinit, sulltanëve osmane si dhe të shumë sundimtarëve të tjere mysliman (e që sot kjo pranohet edhe nga bota perëndimore), ishte besimi i tyre i plotë tek urdherat e Zotit të shpallur në Kuran. Këto janë urdhrave të cilat e ndërtuan bazën e pikëpamjes Islami-ke të qeverisjes: Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo punë që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni. (Surja Nisa : 58) O ju që besuat, vazhdi-misht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dësh-mohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu plotësisht di çka puno-


ni. (Surja Nisa: 135) Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. (Surja Mumtehinet: 8) Është një frazë në politike që thotë: 'push-teti korruptohet, ndërsa pushteti i përkryer korruptohet plotësisht' Modeli i vetëm i njerëzimit ku 'ligji i korrupsionit' nuk zen vend është i fese islame, sepse janë muslimanet ata që i besuan me sinqeritet llahut xh.sh.dhe pa frike e perqafuan fene islame. Tek muslimanet nuk u percaktuan normat morale nga shoqeria e pushteti.. Në Kuran, Allahu xh.sh., Profetin David e solli si një shembull të këtij sundimtari ideal, me mënyrën se si ai qeverisi edhe me ata të cilët e vunë në sprovë autoritetin e tij dhe në anën tjetër, mënyrën se si ai kërkoi falje nga Zoti me përlulje të plotë. (Sure Sad: 24) Fakti se historia e Islamit është plot drejtësi, mëshirë, thjeshtësi (përlulje) dhe qeverisës të pjekur, buron nga ky moral të cilin Zoti ia mëson myslimanëve në Kuran. Meqenëse një udhë-heqës mysliman ia ka frikën Zotit, mundë-sia që ai të korruptohet, të jetë kryelartë, apo mizor, nuk mund te ekzistojë. Natyrisht, udhëheqës që korruptohen dhe largohen nga morali Islamik paraqiten në historinë e isla-mit, mirëpo numri dhe ndikimi i tyre është shumë i vogël. Historia tregon se Islami është i vetmi sistem besimi që mund të sigurojë

një qeverisje të drejtë, tolerante dhe të më-shirshme në Lindjen e Mesme. Pax Ottoma-na që përfundoi me tërheqjen e Perandorisë Osmane nga rajoni, nuk është zëvendësuar ende. Pas osmanlinjve, Lindja e Mesme, së pari kaloi në duart e kolonialistëve Evropian dhe më pas u bë cak i politikave pushtuese dhe agresionit të Izraelit. Ekziston vetëm një arsye themelore për konfliktin e tanishëm në Lindjen e Mesme: fakti se palët nuk duan të bëjnë paqe. Ajo çfarë Izraeli duhet të bëjë është që të veprojnë në përputhje me rezolutën OKB-së 242 dhe të tërhiqet në kufijtë e para 1967, dhe të njohë dhe garantoj të drejtat e popullit të Palestinës. Ajo që Palestina (dhe Arabët tjerë) duhet të bënin është që ti braktisnin synimin e tillë siç është "zbrazja e Izraelit në det" dhe ta pranojnë bashkëjetesën me çifutët. Gjëja më e rëndësishme për të gjithë është që qëllimet e tyre mos ti ndotin me veprime barbare të terrorizimit të civile-ve. Shkurt, në mënyrë që të sigurohet paqja në Lindje e Mesme, të dyja palët duhet të pajtohen të jenë të matura dhe tolerante dhe të bëjnë përpjekje të ciltra për të çlirohen nga racizmi çifutë (Zoinizmi) apo nga shoviniz-mi Arab. Vizioni që nevojitet për këtë çështje është i fshehur në virtytet të cilat morali Is-lam i ka bekuar në Lindjen e Mesme shekuj më parë.

Ervis Isufaj

Lidhjet historike të popullit shqiptar me popujt arabë

Lidhjet historike ne mes popullit shqiptar dhe popujve arabe datojne qe ne lidhjet e hershme fenikase- ilire dhe u fuqizuan gjate periudhes, kur keto popuj paten pushtues te njejte si ishte perendoria bizantine, ajo romake dhe perendoria e fuqishme turke. Ne perpjekje per te mbijetuar, shqiptaret dhe arabet luftuan per te fituar pavaresine e tyre , objektiv te cilin ata e arriten. Duhet te kujtojmë se nje grup i madh i atyre qe ishin rilindasit tane me te njohur, e zhvilluan aktivitetin e tyre duke qendruar ne vendet arabe. Filip Shiroka, Vaso Pasha Thimi Mitko dhe shume rilindas te tjere, gjeten perkrahje nga popujt arabe te Egjiptit , Sirise, Libise, duke i sherbyer forcimit te lidhjeve te popullit shqiptar dhe te popujve arabe dhe duke u bere nje element i rendesishem per vazhdimesine e ketyre lidhjeve deri ne ditet tona. Gjate luftrave, qe popujt arabe bene kunder Perendorise Osmane per te fituar pavaresine, u dalluan komandante shqiptare qe i udhëhoqen arabet ne keto beteja me sukses. Te njohur jane Mehmet Ali Pasha, Rexhep Mati, Ibrahim Mehmet Ali Pasha te cilet, ne ushtrite e tyre, paten edhe reparte te tera ushtrake me luftetare shqiptare. Sidomos, figura e sundimtarit te Egjiptit, Mehmet Ali Pasha me djemte e tij, eshte nder momentet me kulmore te pranise shqiptare ne boten arabe. Ai sundoi ne Egjipt nga viti 1805 deri ne vitin 1848, duke e shtrire sundimin e tij deri ne Siri , Sudan dhe deri ne Arabine Saudite. Krahas rolit te madh per arrijtet ne hapësiren, ku ai sundonte , Mehmet Ali Pasha dha nje kontribut te rendesishem edhe per pavaresine e Shqiperise . Duke u pasuar nga te bijte dhe nga nipat e tij, ku i fundit ishte mbreti Faruk, shqiptaret e drejtuan Egjiptin per 150 vjet. Eshte i njohur edhe numuri i madh i librave qe jane shkruar nga historiane te huaj per kete figure mitike shqiptare te cilen historianet shqiptare duhet ta bejne edhe me te njohur me studimet e tyre. Prania e madhe e shqiptareve ne qytetet arabe solli edhe krijimin e lagjeve shqiptare ne keto qytete. Per fat te keq , sot bashkepunim i shqiptareve me boten arabe nuk eshte



ne ata nivele ku ishte ne ata vite, kur keto lidhje paten lulezuar ne mes te tyre. Nje politikan dhe mik i huaj i Shqiperise u ka dhene nje keshille me vlere pushtetareve te sotem shqiptare ,duke u kujtuar se per shqiptaret shtepia e tyre eshte Evropa dhe se bashkepunimi me amerikanet eshte pozitiv per shqiptaret, por edhe vazhdimi i lidhjeve me popujt arabe eshte ne interes te popullit shqiptar. Te mos harrojme se shtetet evropjane dhe vete amerikanet kane lidhje te fuqishme tregtare me vendet arabe, pa harruar edhe lidhjet dhe bashkepunimin ne fusha te pafundme ne mes te tyre. Nafta arabe vershon ne tregjet evropjane dhe ata amerikane teper lire, kurse Shqiperia nuk e ka nje privilegj te tille, por blen hidrokarbure me cmime te renda nga vendet evropjane. Qendrimi politik i vendeve arabe ndaj Shqiperise ka qene gjithmone shume miqesor dhe historia nuk njeh asnje rast te vetem kur arabet i kane shkatuar shqiptareve vuajtje dhe fatkeqesi. Zhurma, qe nuk mungon te duket ne media kunder ndonje arabi te dyshuar, eshte pjese e ndonje piste qe i intereson qe arabet dhe shqiptaret te flasin per mardhenje historike dhe jo aktuale .I takon politikës shteterore shqiptare qe t'i forcoje lidhjet me vendet arabe, sepse kjo nuk e cenon perkatesine tone evropjane. Artistikisht nje shkrimtar

arab shprehet se ne pranvere vije dallandyshtet si lajmetare pranverre te cilat, pasi rrijne ne Shqiperi disa muaj, ata largohen..., duke treguar me kete detaj se ne vendet arabe Shqiperia dhe shqiptaret jane te njohurdhe te respektuar historikisht. Miku i mire ne kohe te veshtira njihet .Dhe shqiptaret i njohen arabet ne vitet e tranzicionit, kur ndihma nga vendet arabe ishte e permasave te medha, duke i shtuar asaj edhe ndihmat financiare per mijra jetime. Shteti shqiptar duhet te punoje per bashkepunim, jo vetem me Perendimin dhe SHBA, por edhe me vendet e pasura arabe qe kane mundesi dhe deshire per te ndihmuar popullin shqiptar. Vende te tilla jane Egjipti. Katari Emirati Bashkuara arabe, te cilat i cituam si fillim, sepse te gjithë vendet arabe jane te gatshme te bashkëpunojne me Shqiperine. Mardhenijet me vendet arabe jane te percaktuara nga barometri i politikës shqiptare te cilit kolona e zhivez i leviz pa nderprerje nga klima e politikës nderkombetare. Periudha e mbretit Ahmet Zogu ishte koha, kur mardheniet me vendet arabe moren nje zhvillim te madhe, pse mbreterit egjiptiane ishin me origjine shqiptare si: Fuadi dhe Faruku. Ne vitin 1909, ne Egjipt, u hap shkolla e pare shqipe, e cila zhvilloi aktivitetin e saj 25 vjet. Kurse ne vitin 1921, Aleksander

Xhuvani shkoi ne Egjipt ku mori informacione per Mehmet Ali Pashen per te cilin botoi nje liber qe autori thote se duhet ta mbaje ne dore secili shqiptar. Sistemi komunist beri perpjekje te ruaje lidhjet me vendet arabe, por duke e trajtuar kete lidhje ne spektrin politik, sepse keto vende trajtohehin si vende qe luftojne kolonializmin Sot, bota arabe perfaqeson nje potencial te madh ekonomiko-financiar dhe qeveria shqiptare duhet te bashkëpunojte me kete potenciale politiko-ekonomike me te cilen bashkëpunojne edhe vendet me te fuqishme ekonomike te botes. Vizitat e zyrtareve te larte shteterore shqiptare ne vendet arabe si ajo e z. Lulzim Basha dhe z. Topalli jane shenja optimiste qe lidhjet ekonomike ne mes popullit shqiptar dhe popujve arabe te njohin rritje si vazhdim i lidhjeve tradicionale te cilat i kane rezistuar kohes. Populli shqiptar dhe popujt arabe jane paqesore dhe jo terroriste dhe per fat te keq jane keto popuj qe sot paragjohen per veprime dhe tipare qe nuk kane te bejne as me popullin shqiptar , as me popujt arabe.

Muhamer Vuci

Sekretar i Pergjithshem i shoqates "Miqesia Shqiperi – Vendet arabe"

Tregues gjeografikë, ekonomikë dhe kulturorë të Republikës Islamike te Iranit

Siperfaqja e Republikës Islamike te Iranit është 1.64 milion km. katrorë dhe ka një popullsi 71 milion banorë, me tendencë rritjeje 1.6%. Kryeqyteti është Teherani që ka 13 milion banorë, ku janë edhe qendrat kryesore administrative dhe fetare. Perberja fetare është e tillë: 98 % janë muslimane, kurse pjesa tjetër janë të krishterë dhe hebrenj. Një përqindje mikroskopike. Shkëmbimet tregtare me botën janë 144 miliardë dollarë, ku eksportet zënë 88 miliardë dollarë, në një kohë që importet janë vetëm 54 miliardë dollarë.

Republika Islamike e Iranit ka partnere të fuqishme tregtare, ku mund të rrallitet Kina, Japonia, Rusia, Turqia Gjermania, Anglia dhe shumë shtete të tjera me kapacitete të mëdha ekonomike. Ritmi i rritjes ekonomike është 6.2%, në një kohë që kjo ka sjellë një nivel të lartë tek të ardhurat për frymë të popullsisë të cilat arrijnë në 11.700 dollarë.

Vlen për t'u vënë në dukje niveli i lartë në prodhimin e naftës dhe të gazit në të cilat Irani zë vendin e pestë për naftë dhe të dytin në botë për gaz, pas Rusisë, duke bërë që ekonomia iraniane të mos

ndjeje "uri" për industrinë e saj të fuqishme ku punojnë miliona punëtorë. Të mos harrojmë se Republika Islamike e Iranit eksporton 2.52 milion furi naftë në ditë, duke i dhënë një impuls kolossal buxhetit të këtij shteti. I jashtëzakonshëm është edhe eksporti i gazit i cili kap shifrën marramendëse prej 4.33 miliardë m³. Interes paraqet edhe prodhimi i industrisë së automobilitave dhe i mjeteve me zinxhirë që ka tregues bindës pasi Republika Islamike e Iranit sot prodhon 80 mijë autobuze, 11 mijë kamione, 24 mijë traktore dhe i gjithë ky prodhim vetëm mrenda një viti. Kurse, prodhimi i saxhadëve dhe tapetave është pjesë e jetës së iranianeve të cilët zënë vendin e parë në botë. Irani ka sot në shfrytëzim 18283 fabrika në sektorin shtetëror dhe atë privat. Irani është i njohur edhe për ndertimin masiv të digave duke u rralitur pas Kines dhe Turqisë. Tregues të zhvillimit të gjithanshëm të Iranit janë hekurudhat që shtrihen në 8367 km, të pasuara nga rrugë dhe autostrada moderne që kapin gjatësinë 175 mijë km. Republika Islamike e Iranit i kushton një kujdes të madh problemit shëndetësor duke pasë në funksionim 750 spitale me 12 mijë shtrëter, pa harruar edhe 5470 qendra shëndetësore, ku punojnë

100 mijë femra, ose 50% e personalit. Ketyre arritjeve u duhet shtuar edhe numuri i lartë i farmacive që arrijnë në 7540. Interes paraqesin edhe rezultatet në bujqësi, sepse Republika Islamike e Iranit sot ka një prodhim bujqësor 100 milion ton duke bërë një ndër 10 vendet e para në të gjithë botën. Edhe për rendesinë që i kushton mjedisit, Irani është shumë i avancuar, duke pasë një park kombëtar me 1.94 miliardë hektare, ku zona me kafshë të egra zë një sipërfaqe 4.5 miliardë hektarësh. Duke iu kundërvënë propagandës së islami është regjësuar në kulturë dhe art, Republika Islamike e Iranit ka arritur madhështore në këtë drejtim. Sot, në Iran ka 30 axhensi lajmesh, 1800 biblioteka, 198 revista, 42 kanale televizive, 220 milion libra të botuar me 55 mijë tituj në vit, duke u shtuar ketyre arritjeve edhe prodhimin e 100 filmave në vit. Edhe arritjet në fushën e shkencës flasin për mundësinë të diskutueshme të Republikës Islamike te Iranit, që është ndër 10 fituesit e vendeve të para në olimpiadat botërore të kimisë, fizikës, matematikës, astronomisë, duke u rralitur si vend i 7 në botë, i dyti në Azi dhe i pari në vendet islamike. Sot, Republika Islamike e Iranit ka 85 mijë shkolla me 18 milion nxënës dhe 4 milion

studente universiteti, ku numuri i studenteve femra është 1.9 milion. Sidomos arsimit të femrave në Iran është në parametra të lartë duke qenë tregues i rendesishëm i zhvillimit dhe arritjeve të lartë të Republikës Islamike te Iranit. Numuri i femrave në fushën e arsimit dhe edukimit në përqindje është 50.4%. Kurse numuri i femrave të diplomuara në universitete është 200 mijë në vit. Femra iraniane sot zë 25% të posteve drejtuese në administratë dhe në sport sot Irani ka 1 milion sportistë. Të gjithë këto tregues flasin qartë se islami është progres dhe jo regres dhe se shtetet islamike mund dhe duhet të aspironin për arritje në të gjitha fushat që të jenë të barabarta në mes të vendeve me të zhvilluara. Në këtë drejtim, Republika Islamike e Iranit duhet të jetë një argument për të gjitha vendet me popullsi dominante muslimane që të arrijnë pikëta të larta zhvillimi dhe njekohësisht të jenë në gjendje që t'i ruajnë këto arritje nga ata që u prishet gjumi, kur muslimanët bëhen pjesë e zhvillimit të shoqërisë njerezore.

Materjali është marrë nga botimi "Vështrime mbi Republikën Islamike te Iranit".

Peshkopët katolikë kundër holokaustit

Opinionjoni publik botëror tashmë është i informuar se shteti i Iranit ka kontestuar holokaustin e hebrenjve duke hedhur hije dyshimi për numurin e hebrenjve të vrarë në kampet e përqendrimit nga nazistët gjermanë, kontestim ky i amplifikuar edhe me disa karikatura të holokaustit si përgjigje për karikaturat që mediat perëndimore dhe me gjere botuan për Profetin Muhammed, në përpjekje për të denigruar figurën e Tij dhe njekohësisht për t'i dhënë një goditje të rrallës botes islame. Por, tashmë në media janë dhënë informacione të reja në lidhje me shkallën e vertetësisë së holokaustit të heb-

renjve në Luftën e Dytë Botërore. Ata që po e kontestojnë holokaustin janë herarkë të lartë të kishës katolike të cilët kanë deklaruar në media se holokausti nuk është i atyre permasave që thuhet dhe se të vrarët në rrallët e hebrenjve nuk janë dhënë me shifra reale. Herarkët e lartë të kishës katolike arrijnë deri në konkluzione të tilla sa e mohojnë holokaustin kundër hebrenjve, si një dukuri të sajuar. Në Argjentinë është shpallur i padësherueshëm për të qëndruar në token argjentinase një peshkop i cili ka deklaruar se në kampet e përqendrimit të nazistëve nuk ka pasë dhoma gazi dhe se numuri i hebrenjve të vrarë në këto kampe nuk i kalon 300000 persona. Deklarata e këtij pesh-

kopi në Argjentinë pason një tjetër herark të lartë të kishës katolike të cilin vete Papa Benediku i VI e kishte lartësuar në një post të kishës katolike. Ai pat bërë një deklaratë publike ku vuri në dyshim vertetësinë e holokaustit. Këto qëndrime të peshkopeve katolike i kanë detyruar detyruar qarqet e larta fetare në Izrael që të kërkojnë nga qeveria izraelite që të mbajë qëndrim ndaj Vatikanit, duke kërkuar edhe ekstremin që është ndërprerja e marrëdhënjëve diplomatike me shtetin e Vatikanit. Por, duket se situata po qetesohet nga plani i Papes, për të bërë një vizitë në token e shenjtë, Jeruzalem, ku janë edhe qendrat profetike të feve monoteiste. Pavarësisht se cila do të jetë rruga

që do të marrin marrëdhënjët e Papes me Izraelin, kontestimi i Holokaustit nga peshkopët katolike ka lënë një shije të keqe në opinionin publik botëror, sepse e verteta është se hebrenjtë janë ndër popujt më të persektuar nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, krahas popullit sovjetik që humbi mbi 22 milion njerëz, ku ishin 11 milion ushtarë të vrarë neper fushat e betejave kundër ushtrisë naziste, ndërsa 11 milion të tjerë ishin civilë që u masakruan neper kampe përqendrimi ku u dogjen në dhomat e gazit ose u pushkatuan në hapesirat ku ata jetonin.

Selim Gokaj

2 vjet me gazetën BESIMTARI

Idëja për të patur një gazetë ka qenë një ndër pikat më të rëndësishme e cila është diskutuar në shumë mbledhje të kryesive të Shoqatës Bamirese Islame me mendimin që gazeta e shoqatës do të ishte edhe një mundësi me shumë për të afirmuar aktivitetin e saj dhe njëkohësisht për të rritur edhe numurin e mediave të shkruara muslimane. Fale investimit monetar të vellezerve muslimane në Shkodër dhe me gjere u bë i mundur dalja e numurit të parë të gazetës e cila u emërtua gazeta "Besimtari", emërtim ky i dhënë nga një mendim i shprehur prej analistit dhe diplomatit të njohur shqiptar, z. Abdi Baleta. Kur, në publik u prezantua "Besimtari", ai u perballua nga dashamires, të cilët i uruan vazhdimësinë e daljes të saj me shumë numurave të saj. Por "Besimtari" u perballua edhe me skeptike që menduan se kjo gazetë do të kishte ditë të shkurtera dhe numura të kufizuara. Por sot, pas dy vitesh, kur ne po botojmë numurin e 24 që mbyll edhe

vitin e dytë të botimit të "Besimtarit" edhe ata me skeptiket dhe me penalizuesit e kanë kuptuar se "Besimtari" nuk ka dalë si opozitë kundër institucioneve islame, as si paralele e shtypit institucional islam, por ka dalë si gazetë e pavarur për të qenë pjesë e një informacioni sa më të saktë dhe sa më të kompletuar për besimtarët muslimanë. E rëndësishme është se "Besimtari" botohet në 800 kopje si gazete mujore dhe sapo ka filluar të botohet me 12 faqe të formatit të madh që është një tregues i gazetave të afirmuara për të qenë më optimale në dhenien e një sasi me të madhe informacione në krahasim me gazetën e vogël. Gazeta "Besimtari" shpërndahet me sukses në Shkodër, Tiranë, Durrës, Kavajë, Tivar, Ulqin me tendencën për të arritur numurin në 1000 kopje dhe për të kapërcyer pastaj edhe kufijtë shtetërorë të Shqipërisë londineze, sepse numuri 800, që botohet sot është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat e lexuesit me gazetën "Besimtari". Tematika e 'Be-

simtarit" nuk ka qenë denigruese, as penalizuese për religjionet e tjera fetare, por ka qenë informative, duke u bazuar në media dhe në argumente të tjera bindëse. Në qoftë se në fillim ka pasë probleme me drejtshkrimin, ose tregues të tjere të paraqitjes së "Besimtarit", tashmë shumë tregues të tilla janë kapërcyer me idenë për t'i sjellë ata drejt parametrave sa më të ulta. Po të shikohet me kujdes tematika e gazetës "Besimtari", lehtësisht shikohet se ajo i ben mbrojtje politike islamit në hapësirat shqiptare dhe me gjere, sepse islami dhe muslimanët sot nuk penalizohen për numurin e vakteve që falin, as për pozicionin e duarve dhe të kembëve gjatë faljes. Sot, islami sulmohet politikisht duke u akuzuar pa të drejtë për terrorizem dhe për pasojë është etiketuar me nofkat "i dyshuar", "Islamik", "Ekstremist" gjë që ka bërë që muslimanët të përfundojnë në burgje pa gjyq. Atyrë po u ngrijnë llogaritë bankare dhe po u bllokohen pasuritë e patundshme, duke i bërë muslimanët të

falimentojnë ekonomikisht dhe të denohen politikisht. Besojmë se "Besimtari" e ka kryer në mënyrë modeste misionin e tij në mbrojtje të muslimanëve dhe të fesë islame me pikesynimin për të rritur spiralen e këtij kontributi si pjesë e aktivitetit mediatik islam në trajtimin e një tematike të tilla. Mendojmë se duhen falenderuar përmes këtij shkrimi modest të gjithë muslimanët biznesmenë dhe jobiznesmenë, që kontribuojnë për financimin dhe përhapjen e gazetës "Besimtari". Allahu xh.sh. ua shtofte bereqetin dhe ua ndrite jetën atyre, familjes së tyre dhe të gjithë muslimanëve të tjere që punojnë dhe jetojnë në rrugën e fesë islame.

Haxhi Vehbi Dani

Kryetar i Shoqatës Bamirese Islame Shkodër

Ngjarjet e vitit 1997 nuk janë vepër e shqiptarëve

Megjithatë kanë kaluar 11 vjet, ngjarjet e vitit 1997, për të gjithë ata që i përjetuan, nuk mund të harrohen aq lehtë, sepse vetëm në një hark kohor të shkurter u bënë krime të rënda shtetërore dhe personale, u kërcënuar liria e individit dhe u kërcënuar territori i Shqipërisë, u shkatërruan institucionet shtetërore dhe me të tmerrshme ishte rrezimi i shtetit që pati për pasojë një anarki e cila ka dukuri të saj deri në ditët që po behet ky shkrim. Goditja që moren shqiptarët dhe shteti i tyre në vitin 1997 nuk ishte veper e shqiptarëve, sepse nuk ndodh që dikush t'i vere zjarrin me dashje shtepise se vet dhe me pas të ngrohet në zjarrin që ai ndezi vete. Ngjarjet që pasuan 1997 dhe dokumentat e pafund që keto ngjarje lanë pas, tregojnë se të tjere ishin të interesuar që Shqipëria të provonte një shok të tmerrshëm politik, ekonomik, moral, ushtarak dhe social, shok që do të montonte për here të parë në Shqipëri krimin e organuar i cili "do ta kishte grure" me pushtetaret e rinj socialistë, që i solli në

pushtet krismë e armeve e vitit 1997. Ata që e planifikuan 1997 nuk ishin në Shqipëri, por ishin jashtë saj, ku formacione mafioze, politike dhe fetare antishqiptare e planifikuan dhe e monitoruan katrahurën e vitit 1997, e cila, me parulla kundër Sali Berishes dhe Partisë Demokratike, ia nxori Shqipërisë tymin në majë. U lakuan shumë zgjedhjet e vitit 1996 dhe parregullsia e tyre si shkatërrim e asaj që ngjau pas tyre duke penalizuar shtetin demokratik për përvetësim e pa të drejtë të votave të atyre qevotuan. Kjo ishte faktikisht maja e azbergut, sepse ate krim të madh, që preku të gjithë shqiptarët, nuk mund ta bente një monitorim i padrejtë i votimeve, sado shumë të kishin qenë votat e përvetësuar nga Partia Demokratike. Por "Lepuri flinte diku tjetër" Firmat piramidale shkatërrimtare u montuan dhe funksionuan ditën për ditë, duke ia mbushur mendjen shqiptarëve se mund të jetohej edhe pa punuar dhe se kete lumturi mund ta sjellin përqindjet e paimagjinueshme të firmave piramidale që kishin si prapavije bankat perendimore dhe ata amerikane të cilat i financuan deri

sa e quajten të drejtë t'i rrezonin dhe pastaj ky rrezim do të shkatërronte Shqipërinë, Gjithmone, kur shkatërronhet dicka, vjen me pas edhe rindertimi i asaj që është shkatërruar dhe është harresa ajo që fshin gjithshka nga kujtesa. Por, dicka mbetet e paharruar dhe nuk mund të largohet kurrë nga mendja dhe nga syri i njeriut. Dhe keto janë pasojat që lenë pas keto shkatërrime dhe ngjarja të rënda. Ky ishte edhe pikesynimi i atyre që i vunë flakën Shqipërisë në vitin 1997. Sot të krijohet idëja se 1997 mund të gjendet vetëm në arkivat dhe dosjet e historisë dhe e zbetë në kujtesën e atyre që e jetuan me të gjitha dramën të vogël apo të madhë që provuan në kete vit, ku jeta e një shqiptari ra me poshtë se vlera e një dollari, sepse një plumb qorr mund të të linte pa sy ose pa jete. Po të shikojmë me kujdes politiken shqiptare sot, asaj i është rritur vasaliteti ndaj të huajve në një shkallë të tilla, sa ajo, që në lexojmë dhe përcjellim në televizor, e ka humbur interesin, sepse prapavija pas kesaj politike është politika e vertete që zbatohet në Shqipëri sot Eshete e vertete se Shqipëria po hyn në

Nato dhe me vone edhe në BE. Por haraci që do të paguajnë shqiptarët nga keto anetaresime nuk do të jete i vogël. Ai do të kape parametra të rënda koncesioni që shqiptarët dhe shteti i tyre do të bëjnë në emer të ketyre anetaresimeve, kujtojmë angazhimet e trupave tona speciale në operacione ushtarake që janë penalizuar nete gjithë botën për karakterin e tyre pushtues dhe shkatërrimtar për vendet ku ata po zbatohen në emer të një terrorizmi i cili nuk dihet sakte se nga cila pale perfaqësohet në keto beteja. Sot, shkalla e sigurisë për qytetarët është rritur shumë dhe shkalla e sigurisë kombetare u është besuar organizmave të huaja ushtarake, sepse shqiptarët "po i kthejnë armet në parmendë" Arsenalit ushtarak, me të cilin dikur krenohej Shqipëria, tashmë i ka mbetur vetëm emeri. Tanke, avione, artileri dhe arme të tjera po asgjësohen në emer të një mbrojtjeje nderkombetore e cila nuk dihet në se do të funksionojë, kur të "trokase" një mik i paftur në kufijtë e Shqipërisë.

Selim Gokaj

NJE FIGURE QE DUHET NDERUAR DHE RESPEKTUAR

Padrejtësite që iu bënë shqiptarëve nga kongreset dhe konferencat e atyre shteteve që mendonin se e kanë në dorë të tyre fatin e shqiptarëve, kanë qenë të panumurta, ku secila nga keto padrejtësi ka qenë me e rende se tjetra. Por, shkeputja e trojeve shqiptare dhe dorezimi i tyre në duar e fqinjëve të Shqipërisë, është nder veprimet me të denueshme që ka bërë faktori nderkombëtar në dem të problemit shqiptar, sepse një masë e konsiderueshme e popullatës shqiptare mbeti jashtë kufijve. Lenia jashtë kufijve e kesaj popullate nuk arriti që të asimilonte keto shqiptarë të cilët, në mënyrë të vazhdueshme kanë kërkuar të drejtat e tyre dhe kanë kërkuar që mos të trajtohen si qytetarë të dytë në keto shtete ku ata jetojnë. Troje shqiptare, Fuqite e Medha i dhuruan Greqisë, i dhuruan Serbisë, por i dhuruan edhe Malit të Zi, i cili kishte plane të vjetra për të mohuar të drejtat e shqiptarëve që jetonin atje, plane që nuk pushuan se vepruari për vite me rralle, duke kërkuar që t'u ngushtojnë hapësirën e të drejtave shqiptarëve në Mal të Zi. Por, edhe

levizja e shqiptarëve për të fituar të drejtat e tyre nuk ka pushuar për asnjë moment, duke ngritur udhëheqës dhe drejtues të shquar të kesaj levizjeje dhe krahas tyre edhe qytetarë të thjeshtë që kanë qenë pjesë e kesaj levizjeje patriotike, për të mbrojtur të drejtat e tyre. Levizja për të drejtat e shqiptarëve ishte e njohur edhe në një hapësirë të vogël të Malit të Zi, ku jetojnë shqiptarë e cila quhet Kraje. I njohur në këtë hapësirë për idetë e tij nacionaliste dhe për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat shqiptarëve, është edhe Isuf Selman Muriqi. Ky qytetar i thjeshtë, por i dalluar për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Mal të Zi, i përket atij brezi shqiptarësh që ka lindur jashtë trojeve të Shqipërisë londineze, në troje shqiptare që i janë dhuruar Malit të Zi nga Fuqite e Medha, për të zvogëluar sa më shumë permasat e shtetit shqiptar. Ky zotëri i nderuar ka lindur në Kraje dhe ka jetuar në mënyrë të ndershme duke tregetuar prodhimet e tija bujqësore. Në një takim të prodhuesve bujqësorë dhe blegtorale, Isuf Selman Muriqi foli për një problem shqetësues që kishte të bënte me shkëlqjen e të drejtave

te shqiptarëve, sepse në tabelat e dyqaneve nuk shkruheshin lajmërimet dhe tregues të tjerë të kesaj natyre në gjuhën shqipe, por vetëm në gjuhën malazeze. Protesta, që bëri, i kushtoi shtenjtë këtij patrioti të ndershëm, sepse, si tregon ai vetë përmes shënimeve në një fotografi të cilën edhe do ta botojmë, u burgos nga organet shtetërore malazeze dhe u dënuar me burg të cilin e bëri në burgun e Kotorit. Denimi nuk ishte i madh në vite, por ishte një paralajmërim për të gjithë shqiptarët, që do të kërkonin të drejtat, se ata do t'i prisnin burgun si Isuf Selman Muriqin. Në momentin, kur ai po vuante denimin në vitin 1985, ishte muaji i Madhnueshëm i Ramazanit dhe ai, si musliman i devotshëm që ishte, e mbajti ramazinin në qelitet e burgut. Rojet e burgut dhe ata që drejtonin burgun, bënë përpjekje të medha që ta bënin ta ndalonte mbajtjen e ramazanit dhe, kur ai nuk pranoi, ata ushtruan ndaj tij dhunë fizike, por pa arritur që ta ndalonin të mbante Ramazinin Pasi doli nga burgu, ai nuk e ndaloi aktivitetin e tij në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Mal të Zi dhe deklaronte haptas, në mes të shqiptarëve, se

atij nuk i dhimsej jeta për atdhe dhe për fe, sepse ai dhe familja e tij ishin të perkushtuar në fenë islame dhe se ishin patriotë të flaktë për të drejtat e shqiptarëve. Qëndrimet e këtij patrioti dhe fetari të perkushtuar i kushtuan vëmendje dhe i krijuan hapësira informative dhe mediat në Mal të Zi. Mediat malazeze e akuzuan për nacionalizëm, kurse gazeta shqiptare "Koha Javore" e mbështeti qëndrimin e tij në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Mal të Zi. Isuf Selman Muriqi i porosiste shumë shqiptarët që ata ta ruajnë dhe mos ta humbasin gjuhën shqipe, sepse ajo është pjesë e identitetit të tyre që i bën të dallueshëm si popull nga të tjerët. Duket se ky zotëri i nderuar e ka pasur të vështirë që të jetojë në Mal të Zi, ku hapësira për të jetuar të lirë shqiptarët nuk është e mjaftueshme dhe ka emigruar jashtë Malit të Zi. Isuf Selmani sot jeton me familjen e tij në SHBA, por mallin për Krajen e tij të largët e ka shumë të madh, sepse ai do të dësheronte të jetonte në Kraje, aty ku ka lindur ai dhe paraardhësit e tij, por i lirë dhe me të gjitha të drejtat që duhet të gëzojë një njeri i lirë.

Samir Hoxhiq



DASHURIA PER NENEN

Tregimi në vijim është një ngjarje e shkurtër, mirëpo shumë tërheqës dhe kuptimplotë. Mbetëm me shpresë se do t'u pëlqej shumë...Pas 21 vitesh martese, hasa në një dashuri të çiltër.



Para disa kohesh, fillova të kaloj kohën me një grua të ve qysh prej 19 vite. Gruaja ime me parapriu me fjalët e saja, duke thënë: "E di shumë mirë se sa e doni atë". Gruaja për të cilën me këshillonte shoqja ime të kaloj çaste me të, ishte Nëna ime, e cila kishte mbetur e vejë qysh para 19 viteve. Punët dhe obligimet e shumta si dhe 3 fëmijët kishin bërë që nënën time ta vizitoj shumë rrallë. Një ditë, gjeta kohën që ta ftoj nënën time për darkë. Mora telefonin dhe i telefonova. Ishte bërë vonë dhe Nëna u bë merak kur ma dëgjoi zërin se nuk e kishte zakon që të fliste me dikën në kohë të vona dhe me pyeti: Si je biri im? Mirë jam Nënë - iu përgjigja. Te telefonova nga dëshira për të kaluar disa çaste me ju. Me pyeti: Vetëm ne të dy? U mendua pak dhe me tha: Me pëlqen propozimi yt. Ditën e enjte, pasi mbarova orarin e punës, u nisa për në shtëpinë ku banonte nëna ime. Ndihesha paksa i shqetësuar. Kur arrita në shtëpinë e nënës, vëreja se edhe ajo ishte paksa e merakosur dhe ishte duke pritur te dera e shtëpisë.

Ishte veshur bukur dhe m'u duk se kishte veshur fustanin e fundit që ia kishte blerë babai im, pak para se të vdiste. Duke buzëqeshur si një melek me tha: Biri im! Te gjithëve iu kam thënë se sonte do të dal me djalin tim dhe që të gjithë janë gëzuar. Te gjithë me padurim presin kthimin tim për t'ua sqaruar hollësitë e këtij takimi.

Shkuam në një restorant jo të zakonshëm, mirëpo i bukur dhe i qetë. Nëna u mbështet në krahun tim dhe dukej sikur të ishte një zonje. Pasi u ulem, fillova ta lexoj listën e gjellërave, sepse Nëna nuk ishte në gjendje të lexonte, përveç shkronjave të mëdha. Ndersa po lexoja listën e ushqimeve, Nëna me shikonte me një buzëqeshje të gjerë, me dy buzët e saja të çara. Ajo ndërhyri, duke thënë: "Kur ishe i vogël, unë isha ajo që lexoja për ju". Une iu përgjigja duke i thene se tani ka ardhur koha të ta kthej këtë borxh dhe unë po lexoj sot për ty. Çlodhu dhe pusho nëna ime - i

thashë. Gjatë tërë mbrëmjes biseduam dhe nuk kishte asgjë të rëndomtë, me përjashtim të nostalgjive dhe përditshmërisë sonë. Qëndruam aq shumë, sa ishte bërë shumë vonë. Pasi u kthyem dhe arritëm te dera e shtëpisë, Nëna m'u drejtua me këto fjalë: Kam dëshirë që të dalim së bashku përsëri, mirëpo me kusht që unë të paguaj. Ia putha dorën dhe i thashë lamtumirë. Pas disa ditësh, me erdhi lajmi se Nëna kishte ndërruar jetë. Kishte vdekur nga një goditje në zemër.

E tërë kjo ndodhi për një kohë shumë të shkurtër dhe unë asgjë nuk munda të bëj për të. Kaluan disa ditë dhe nga posta me arriti një letër e dërguar nga restoranti, në të cilin kishim darkuar unë dhe Nëna ime. Në të kishin qenë disa fjali të shkruara nga dora e Nënës sime: "Kam paguar faturën para kohe, duke e ditur se nuk do të kem rastin të takohem me ty përsëri. Me rëndësi është se bëra pagesën për dy persona, për ju dhe gruan e juaj. Ju assesi nuk mund ta përshkruani vlerën e asaj nate, në të cilën darkuam sëbashku. Te dua shumë biri im". Në këtë moment, arrita të kuptoj domethënien e fjalës "Dashuri" apo "Te Dua".



Nuk mund ta kuptosh domethënien madhështore të kësaj fjale derisa nga dashuria juaj të mos vjelë mirësi dhe bukuri edhe pala tjetër, ashtu siç beri Nëna ime. Asgjë nuk ka vlerë me shumë sesa Prindërit, e në veçanti Nëna. Dhuroja kohën të cilën ata e meritojnë...Duhet ditur se ky është obligim i Allahut dhe i Prindërve. Prandaj, këto gjëra nuk shtyhen. Me këtë rast, me ra në mend tregimi kur që pyetur Abdullah ibën Omeri: "Nëna ime është e moshuar, nuk mund të lëvizë fare dhe me duhet ta bart në çdo vend, madje edhe kur ta kryen nevojën...nganjëherë nuk ka fuqi që të përmbajë veten kështu që, kryen nevojën duke qenë në duart apo shpinën time...A mendon se unë e kam kryer obligimin ndaj saj? Ibën Omeri u përgjigj: A ke harruar fëmijërinë tënde, kur ju vepronit kështu me Nënë tuaj?! Ju po i shërbeni, duke shpresuar vdekjen e saj. Ndersa ajo iu shërbente juve, me gjithë mundimet dhe lodhjet që kishte duke shpresuar jetën dhe lumturinë tuaj". Vërtet dallim i madh në mes këtyre dy qëndrimeve...

Shpresojmë se porosia dhe mesazhi i kësaj ngjarjeje do t'iu arrij edhe atyre të cilët ende i kanë prindërit gjallë!!!

Përktheu nga gjuha arabe: Mr. Feim Dragusha

Marrë nga : Assoc. Prof. Dr. Walid. I. S. Sharaiyra ish- ligjërues në IIUM

TE USHQEHEMI ME HALLALL DHE LARG HARAMIT

Njeriu nuk mund te konsiderohet si nje gjallese e zakonshme ashti si i konsiderojme miliona gjallesa te tjera ne toke, sepse Allahu xh.sh. i ka dhene nje status te vecante si ai te dallohet nga gjallesat e tjera gjate viteve qe do te jetoje ne kete bote tranzitore. Allahu xh.sh. e trajton njeriun si kryeqenien e tij ne planet dhe kjo eshte arsyeja pse Allahu xh.sh. i ka dhene njeriut nje dhurate qe eshte morali i cili formon personalitetin e njeriut qe, duke grupuar njerez qe punojne ne sfera te ndryshme te jetes, formojne moralin e nje shtrese te caktuar, ose te nje populli te caktuar. Morali njerezor mbahet ne kembë nga te gjitha rregullat dhe ligjet qe Krijuesi ka krijuar per njeriun i cili e ka obligim qe t'i zbatoje ata. Keto ligje e mbrojne njeriun ne dy aspekte. Se pari, ne aspektin moral dhe se dyti ne ate fizik. Keto aspekte zgjasin tek njeriu sa zgjat vete jeta e tij. Sheriati i ndan keto ne dy kolona qe jane rregulla dhe ligje qe te cojne tek ajo qe lejohet dhe tek ajo qe nuk lejohet ne fene islame e thene ndryshe ne hallall dhe ne haram. Ky ligj hyjnor ka qellim persosjen e jetes njerezore deri ne kufijte e lejuar te kesaj persosjeje.. Mendojme te trajtojme ne kete shkrim te lejuaren dhe te palejuaren ne ushqimin tone me origjine shtazore. Mishi eshte ushqimi me i rendesishem i njeriut, sepse permes tij njeriu merr kalori te medha ne numur si: undyrna, proteina, kripera minerale etj. Kafshet, me te cilat ushqehet njeriu, jetojne ne toke dhe ne uje. Kafshet e ujit jane te lejuara per t'u ngrene nga njeriu, kur jane te gjalla, ose edhe kur jane te ngordhura. Ne Kuranin e Madheruar thuhet : "Pastaj Ai eshte qe ,nenshtroi detin qe prej tij te hanin mish te fresket." (Nal,14). Pastaj ajetet vazhdojne "Gjahu dhe ushqimi ne det u eshte lejuar si perjetim per ju dhe per udhetaret".



(Maide,96).

Kafshet qe jetojne ne toke, Allahu xh.sh. i ka ndare ne kafshe qe mund te hahen dhe ne kafshe qe nuk mund te hahen. Kurani i Madheruar e ndalon konsumimin e mishit te derrit, konsumimin e mishit te ngordhur, ose te therur jo ne emer te Allahu xh.sh., duke shtuar se eshte e ndaluar edhe ngrerja egjakut te derdhur te kafsheve qe jane te lejuara per t'u ngrene. Pejgameri a.s.e ka ndaluar ngrjenjen e kafsheve qe kane kthetra dhe kane dhembë shqyes si; ujku, luani dhe pra etj. Kemi edhe nje ndarje tjeter tek kafshet. Ata jane kafshe shtepiake, qe njeriu i ther per nevojat e veta, por gjithmone sipas ligjeve te sherjatit qe urdheron te priten me mjete te mprehta ne fyt, ku eshte gabzherri dhe dy damaret e qafes duke na kujtuar te derdhet gjaku sa me shpejt qe kafshes t'i dale shpirti sa me lehte. Disa nga kafshet shtepiake sillen si egersira dhe eshte e veshtire te theren si te tjerat. Prandaj, Profeti a.s. porositi qe ata te vriten si kafshet e gjahut, pra me arme. Gjate therjes se kafshes duhet te permendet vetem emer i Allahu

xh.sh. Ne Kuranin e Madhneshem eshte saktësuar nje perkujdesje e tille per njerezit "Ju hani nga ajo qe eshte therur dhe permendur emer i Allahut xh.sh. (El ,En,nam118) , (Dhe mos hani nga ajo qe para therjes nuk eshte permendur emer i Allahu xh.sh.). Vertet ajo ngrenje eshte gjynah El, En,nam121). Ne nje hadith te tij ,Profeti a.s. thote: "Hani ate prej se ciles rrjedh gjaku dhe ne te cilen permendet emer i Allahut" Kur nuk dime ne se eshte permendur emiri i Allahut, kur eshte therur nje kafshe, ne duhet te hame ate mish duke permendur emerin e Allahut xh.sh., veprim per te cilin ka porositur edhe Pejgameri a.s. Kur, gjate procesit te therjes permendet emer i Allahut xh.sh, njeriu ndjehet mire, sepse ka marre leje tek Allahu xh.sh, per t'i marre jeten nje krijese se Tij. Para therjes, Profeti a.s porositi prehenjen e mjetit prerës dhe venien e kafshes ne pozicion te pershtatshem, duke thene se Allahu xh.sh. ka urdheruar miresjellje ndaj cdo gjeje." Ne se vritni, vritni me miresjellje. Ne se therni, therrni me miresjellje". Ne periudhen para islame, therja behej ne emer te idhujve dhe kafsha trajtohej mi-

zorisht. Kishte raste qe deve se gjalle, pa e therur, i prisnin vetem gungen. Profeti a.s. i ndaloi keto veprime dhe tha se, ne se pritet dicka nga kafsha, kur ajo eshte gjalle, atehere kafsha quhet e ngordhur dhe mishi ne kete rast eshte haram. Sot, ne qytetin tone, shume kasape e therin kafshen sipas kushteve te sheriatit, peshojne me ndershmeri duke fituar se vape nga Allahu xh.sh. Keta kasape jane te tradites, por jane edhe te rinj te cilet duhen falenderuar per perkushtimin e tyre fetar. Kasape te tille ka ne familjen Hoxha, Gercari, Katalina, Gramshi. Te kasapet e familjes Katalina kam asistuar personalisht dhe kam pare se si kafshet thereshin sipas sheriatit. Sevapet qe marrin keto kasape, qe e kthejne mishin ne hallall, eshte veprim qe duhet nderuar, sepse i ushqejne qytetaret e tyre me mish hallall. Allahu xh.sh inshalla na ben prej atyre qe jane te devotshem e mendjekthjellet per te shikuar dhe per te vepruar gjithmone nga e lejuara (hallalli) ne jeten tone te perditshme.

Bujar Shehu

FRAGMENTE NGA BOTIMET ISLAME


BOTA ISLAME I SHPETOI MUSLIMANET E BOSNJES NGA GENOCIDI SERB

Ardhja e Ajatollah Xhenetit, si autoriteti më i lartë fetar islam që vizitoi Sarajevën gjatë luftës dhe pak më vonë, vizita e Muhamet Alisë, sekretar i përgjithshëm i një institucioni të lartë fetar nga Arabia Saudite, gjatë bombardimeve të vazhdueshme mbi Sarajevën, ishte një ngjarje e madhe për popullin musliman të Bosnjës. Ardha e tyre na nxiti që të jemi të vendosur në qendresën tonë kundër genocidit të serbeve ndaj muslimaneve në Bosnje. Ata na e zbuten

dhimbjen dhe treguan se janë me ne në vështirësitë që po kalojmë, na forcuan besimin dhe shpresën në drejtësinë e luftës sonë. Ndoshta, Bota Islame mund të kishte bërë më shumë për të ndaluar genocidin në Bosnje, por duket se Bota Islame kishin më shumë besim se duhej tek politikanët evropjanë dhe ata boterorë. Megjithatë, duhet të pranojmë se po të mos ishte ndihma e Botes Islame, nuk do të kishte Bosnje të lire, as muslimanë në Bosnje dhe as nuk do të kishim këto forca ushtarake dhe morale që kemi sot. Duhet të pranojmë se Bota Islame na ka

dhënë ndihmë jashtëzakonisht të madhe për refugjatët tane, si mrenda Bosnjës, ashtu edhe jashtë kufijve të saj, neper bote.

Materjali është pjesë e një interviste të dhënë nga Kryetari i Bashkësisë Islamike të Bosnjës Resul- Ulema, Mustafa Ceriq, e botuar tek vëllimi "Besim Fetar, Populli dhe Atdheu"



TOLERANCA E LUFTETAREVE MUSLIMAN NE LUFTEN E BOSNJES

Duke lexuar kujtimet e ish-presidentit të Bosnjës, Alija Izetbegović, shikohet se luftetaret muslimanë, megjithëse iu shkatërruan xhamitë, medrezetë dhe veprat e tjera të kultit islam, ata nuk preken kishat katolike të kroateve dhe manastiret dhe kishat serbe. Ne po citojmë një fragment nga një fjalim i kryetarit të Bosnjës në kohën e luftës dhe presidenti i këtij vendi pas luftës, Alija Izetbegović, për të parë se cila ishte porosia që merrnin luftetaret e armatës muslimane të Bosnjës në ato vite, kur Bosnja ishte përfshirë nga flakët e luftës etnike-fetare, ku palet ndësheshin neper fushebeteja për jete a vdekje.

"E shihni se Zoti na ka vene në sprovë të renda. Na kanë therrur dhe na kanë vrarë grate tona dhe femijet tane. Na kanë rrenuar xhamitë tona, por ne nuk do të vrasim gra dhe femi-

je dhe nuk do të rrenojmë kisha. Ne nuk do ta bëjmë këtë, se kjo nuk është rruga jonë. Këtu ka edhe ushtarake dhe unë u kujtoi atyre që këto porosi ta përcjellin në të gjithë hapësirat ku bëhet luftë. Ne do ta fitojmë këtë luftë, sepse ne respektojmë fenën e të tjerëve dhe kombin e të tjerëve, pa harruar të respektojmë edhe bindjet e tjera politike. Ne përpiqemi që të ruajmë tiparet njerezore edhe në këto situata të rënda që po kalon Bosnja. Ne se jemi tolerantë, jemi se pari sepse jemi muslimanë dhe pastaj se jemi evropjanë, sepse tolerance jonë ka prejardhje muslimane dhe jo evropjanë. Fale këtij qëndrimi të muslimaneve, edhe sot në Serbi, ku kanë sunduar turqit 400 vjet, kanë mbetur të paprekur manastiret ortodokse në Decan, Gracanicë, Sopocani. Ata kanë mbetur të paprekura, sepse kështu thote libri i shenjtit të muslimaneve të cilin ne e respektojmë. Kur themi se do të respektojmë kishat e themi këto, sepse kështu

ne respektojmë dhe zbatojmë fjale për fjale urdherin e librit të shenjtit të muslimaneve i cili thote se një gjë e tillë kundër kishave dhe fese se të tjerëve nuk duhet bërë. Në Bosnje, në këto luftë, janë shkatërruar qindra xhamia dhe kisha, por asnjë nga boshnjaket. Të gjithë popujt e krishterë dhe të gjitha monumentet e tyre mesjetare i kanë mbijetuar pushtetit 500 vjeçar turk, por nuk i mbijetuan as tri vjet "pushtetit evropjan", sepse janë djegur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fashizmi dhe komunizmi nuk ishin "prodhimë" aziatike por "prodhimë" evropjanë. Unë e nderoi Evropën, por ajo ka mendim të lartë për vehtën. Edhe sot ajo nuk reagon ndaj paraqitjes së një fashizmi të terbuar në Ballkan që po masakron muslimanët"

Fjalimi është mbajtur në një seminar të shtabit të armatës muslimane të Bosnjës

NJE DITAR PER GAZEN MARTIRE

Eshte dita e njëzete e agresionit izraelit në Gaza. Ora është 3 e mëngjesit. U zgjova nga gjumi, mora abdes, fala dy reqate namaz dhe bëra dua për Gazën. Njeriu nuk mund të mos shqetesohet nga pamjet rrëqethëse të pasojave të bombardimeve nga ajri, toka e deti, në një hapësirë gjeografike prej 360km², me gjatësi 36 km dhe gjerësi 10 km, në të cilën është vendosur popullata më e dendur në sipërfaqen e tokës, 1 milion e gjysmë banorë palestinezë. Viktimat e shumta civile, me një numër të madh fëmijësh, e kanë tejkaluar çdo mase të të gjitha konventave të mundshme botërore për mbrojtjen e civilëve gjatë luftës. Gaza na sfidoi edhe në shqiptarëve myslimane në të gjitha trojet tona tona, duke treguar se në kemi rene poshte obligimeve që kemi si shoqëri myslimane në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, sepse nuk ishim të afte të benim një organizim të denje në mbështetje të popullit palestinez në Gaza që po masakrohej nga ushtria izraelite në sy të komunitetit nderkombetar, që fajsonte me shume palestinezet për disa raketa artizanale që

leshonin drejt Izraelit, se ushtrinë izraelite që masakronte një popullsi të pambrojtur me armet moderne të kohës. Reagime në mbrojtje të popullit palestinez në Gaza dhe denimit të genocidit sionist kundër tij, beri Forumi Musliman i Shqipërisë dhe Forumi Musliman i Kosovës të cilet, përmes deklaratave të tyre mediatike, treguan se jo gjithshka në trojet shqiptare është rrafshuar në mbrojtje të vëllazërimit muslimane. Është për t'u falënderuar dhe për t'u mbështetur organizimi i lartë dhe madhështorë i muslimaneve në Sanxhak, Bosnjë e Turqi, ku u mbajtën e hytbet e xhumasë për Gazën, u bë tubimi për ndihmë në të holla nëpër xhamia, u realizua organizimi i demonstratave dhe protestave në përkrahje të popullit palestinez, duke u shtuar ketyre edhe aksione të shumta humanitare, në ballë të të cilëve kanë qenë bashkësitë islame në Sanxhak, Bosnjë e Turqi. Në shqiptarëve myslimane në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, na ka munguar guximi, por edhe mosdija e organizimit të çfarëdo aksioni humanitar, e tubimit të mjeteve financiare për ndihmë popullit të masakruar të Gazës, të protestave

dhe demonstratave në përkrahje të popullit palestinez. Në, si she-mbull për të mirë në Kosovë kemi Lëvizjen Vetëvendosja, si mostër e shkëlqyer i një organizimi të tillë. Por, që të realizohet një organizim i tillë, duhet një parapërgatitje që fillon me sensibilizimin e shoqërisë, me mbajtjen e një konferenceje për shtyp, të shpërndarjes së lajmërimeve për njoftimin e datës, vendit dhe orës së mbajtjes së protestës, fjalimet e përgatitura më parë, sloganet që do të brohoriten, pankartat e shkruara, fillimi dhe mbarimi i saj, kujdestaria e kujdestarëve të caktuar më parë, për të mos devijuar protesta, për të parandaluar depërtimin, apo infiltrimin e personave të tjerë që do të mundohen t, ia ndërrojnë karakterin paqësor protestes, pa harruar njoftimin me kohë të policisë, të mediave elektronike dhe të shkruara. Por, për momentin, në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, mungon një qasje e tillë në shoqërinë myslimane, për të ngritur zërin në formë të organizuar, kur shkelen të drejtat njerëzore, fetare, kombëtare, civilizuese, në rastin konkret të palestinezëve, por edhe të rasteve të tjera në botën islame dhe me gjere. Po të mos

ishite tubimi spontan në Prizren, i mbajtur pas namazit të xhumasë në Shadërvan dhe marshimi i tij deri në Namazgjah, në do të ishim turpëruar para botes islame dhe pse jo edhe para asaj Perëndimoreve. Kete e themi, sepse në përkrahje të popullit palestinez dhe në denimin e agresionit dhe genocidit izraelit në Gaza, kanë demonstruar qindra mijra demonstrues në Izrael, SHBA, Angli, France dhe thuajse në të gjithë botën, duke treguar se denimi i krimeve është tregues i demokracisë dhe i emancipimit të shoqërisë njerëzore. Urojme që myslimanet shqiptare të behen sa me pare pjese e kësaj demokracie dhe i këtij emancipimi, duke mos harruar t'ju urojme edhe forcimin e imanit dhe rritjen e përkushtimit në fene islame që sprovat në mbrojtje të vellezerve myslimane dhe të problemeve që janë pjese e fese islame, t'i kalojnë me sukses.

Faik MIFTARI

Shkrimi është derguar për gazeten Analist dhe studjues në Kosovë

"Besimtari"

UMNIKU DHE KFORI MBESHTESIN SERBET NE KOSOVE

Ne një interviste të dhënë në stacionin televiziv Top Cennell, korespondentja e kësaj media televizive nga Kosova, Alma Lamaj komentoi gjendjen në minierën e njohur të Trepcës e cila ka qenë dikur krenaria e Kosovës dhe e vetë ish-Jugosllavise, sidomos e njohur për greven e famshme të punëtorëve shqiptarë që kërkonin kushte më të mira pune dhe një pagë më të mirë për punën që bënin në këto miniere. Të gjithë e kujtojmë këtë grevë që mori drejtim politik kundër diskriminimit politik dhe ekonomik që u bëhej shqiptarëve në ato vite, kur Kosova ishte pjese e territorit të Serbisë, në kuader të Jugosllavise së dikurshme, Shkeputja nga Serbia, me ndihmën e Aleancës së

Atlantikut dhe e mbështetur edhe nga luftetaret e repeteve të UCK, u krijoi shpresën kosovareve se ata tashmë do të ishin pronarët e vertete të minierës së Trepcës. Por në terren ngjarjet nuk po ecnin në atë linjë që paten menduar ata që luftuan dhe ata që e mbështetën luftën për Pavaresi në Kosovë në vitet 90. Pjese e kësaj ngecjeje politike dhe ekonomike u bë edhe miniera e Trpcës e cila kaloi në një krizë të planifikuar duke ndaluar prodhimin e saj deri në një reduktim krejt të paparashikuar që u pasqyrua edhe në zvoglimin e numurit të minatorëve në nivele të papara ndonjëhere. Duke folur për gjendjen aktuale në këto miniere, e cila gjendet në pjesën veriore të Kosovës, në Mitrovicë, gazetaria Alma Lama tranmetoi lajmi shqetesues se faktori nderkombetar që operon

në Kosovë dhe sidomos në Mitrovicë përmes Ummikut dhe Kforit po i trajton punëtorët e minierës së Trepcës me dy standarte. Punëtorët serbë të minierës po trajtohen si "te nenes" duke u paguar honorare dhe rroga pa punuar neper galerite të minierës me motivin se kushtet në minierën e Trepcës nuk janë më rëndë parametrave normale që duhet të ketë një miniere për të mirepritur minatorët e saj. Kurse kosovaret, që kanë punuar në minierën e Trepcës po trajtohen nga Ummiku dhe Kfori si "te njerkes" duke u mbajtur larg kësaj miniere dhe duke u lenë pa paga dhe pa të ardhura të tjera, duke u mohuar të drejtat që e ata kanë si pjese e kolektivitetit të miners së Trepcës. Korespondentja e Topit nga Kosovë tha se punëtorët shqiptarë të minierës së Trepcës do të protestoj-

në kundër diskriminimit që po u bëhet atyre nga perfaqesuesit nderkombetarë që në Kosovë po trajtojnë kosovaret si "te nenes". dhe të mos harrojmë se Kosova dhe kosovaret paten shpresuar shume të faktori nderkombetar para dhe pas Pavaresise së Kosovës por që duket se në terren ngjarjet po zhvillohen ndryshe nga sa ishte parashikuar sepse interesat e Kosovës dhe të kosovareve në shume tregues politike dhe ekonomike po anashkalohen nga faktori nderkombetar i cili ka lidhje të vjetra dhe të reja ekonomike dhe politike me Serbinë e dikurshme dhe me Serbinë e sotme me të cilën i lidh edhe penalizimi i shqiptarëve dhe e vetë shoqërisë shqiptare.

Alban Kastrati

INFORMACIONE MEDIATIKE PER ISLAMIN

NE AFGANISTAN NUK MUND TE FITOHET LUFTA ME OPSIONIN USHTARAK

Sapo ku perfunduar ne Munich te Gjermanise konferenca nderkombetare per problemet e sigurise, ku pjesemarrës ishin perfaqesues te shteteve qe jane te implikuara ne zona "te nxehta" dhe qe jane te interesuara qe problemet ne keto zona te marrin zgjidhje qe do te jene te pranueshme per politiken e ketyre shteteve dhe njekohesisht optimale edhe per palet qe jane pjese e ketyre konflikteve. Nje nder problemet me shqetesuese eshte pa tjetër lufta qe po behet ne Afganistan, ku jane perfshire trupat amerikane dhe ata

te koalicionit qe mbeshetin amerikanet ne kete nderhyrje ushtrake. Perballe tyre jane luftetaret talebane qe kane hyre ne beteje qe te nxerrin jashte Afganistanit ushtrite amerikane dhe aleatet e tyre dhe njekohesisht ata kerkojne edhe rrezimin e qeverise se Kabulit te cilen talebanet e akuzojne si sajese e amerikaneve dhe e Perendimit qe lufton

ne mbeshetje te kesaj qeverie. Por, ne terren betejat po ashper-

sohen ne menyre te frikshme dhe udheheqes ushtarake dhe politike po binden se obsioni ushtarak eshte i pamjaftueshem per te fituar betejën me talebanet ne Afganistan. Prandaj, ne konferencen nderkombetare ne Munich te Gjermanise u debatua ashper per ate se si duhet te operohet ne vazhdim ne fushebetejën e Afganistanit. Ministri i jashtem gjerman, vendi i te cilit eshte i angazhuar direk ne betejën me talebanet, si pjese e koalicionit proamerikan, deklaroi ne kete samit se me talebanet nuk eshte i mjaftueshem obsioni ushtarak, sepse ky obsion nuk mund te sjelle fitoren per forcat e koalicionit, por duhet qe te shfrytezohen edhe opsione te tjera te cilat mund te jene bisedime me drejtuesit e luftetareve talebane, duke synuar qe konflikti te njohe nje zgjidhje te pranueshme per te gjitha palet. Deklarata e ministrit te jashtem gjerman behet pak kohe nga momenti, kur nje deklarate te tille e pat bere nje officer i larte britanik i inkuadruar ne forcat e koalicionit e cila u pasua edhe nga nje deklarate e njejte e bere nga perfaqesuesi i OKB ne Afganistan Kai Aide. Ndersa pre-

sidenti afgan Karzai tha se trupat e Natos duhet te kursejne civilet gjate bombardimeve qe ben aviacioni dhe artileria ne betejave me talebanet. Deklarata e Karzait ka parasysh numurin ne rritje te civileve te vrare nga bombardimet qe rrit urretjen ne popull dhe njekohesisht rrit edhe mbeshetjen popullore per luftetaret talebane. Por, duket se prespektiva per te pushuar armet ne Afganistan eshte e larget, sepse presidenti ri amerikan, Obama eshte me i vendosur se paraardhesi i tij Bush, per te vazhduar luften ne Afganistan duke kerkuar qe nga Iraku te terheqe trupat ushtrake, kurse ne Afganistan t'i shtojte trupat ushtarake, per ta fituar betejën me talebanet. Ne nje deklarate te bere ditet e fundit, i derguari i Presidentit Obama ne Afganistan, politikani i njohur Hollbruk, paralajmeroi se beteja ne Afganistan do te jete shume me e ashper se ne Irak, duke lene te nenkuptohet se kesaj rralle amerikanet kane perballe tyre nje kundeshtrik qe nuk mund ta kalojne lehte, sepse ai eshte jo vetem i perkushtuar qe te luftoje, por duket sedhe armet nuk i mungojne

ne cilesi dhe ne sasi. Ka shume mundesi qe forca, te cilat qendrojne me lart se talebanet, jane te interesuar qe vatra e luftes ne Afganistan te mbetet e nderur dhe humbjet njerezore nga te gjitha palet te vazhdojne deri se ata, qe planifikojne nderzjen e vatrave te zjarrit neper bote, te kene arrite qellimet e tyre. Mendojme se qeveria e presidentit te ri amerikan do ta njohe realisht situaten ushtrike ne Afganistan dhe njekohesisht do te kete parasysh humbjet njerezore ne rrallet e trupave amerikane dhe po keshtu do te analizoje shpenzimet e jashtezakonshme te kesaj lufte te pakuptim, duke iu shmangur betejës ushtarake ne terren, per ta zevendesuar ate me tryezen e bisedimeve e cila ka provuar se eshte zgjidhja me pak e kushtueshme dhe me e sigurte per te depozituar nje konflikt ne dosjen e arkivave historike me mbishkrimin e njohur; "Kjo dosje i perket te se kaluares".

Selim Gokaj

MUSLIMANET DO TE SHPETOJNE NGA BURGJU I GUANTANAMOS

Presidenti ri amerikan, sapo ka marre detyren e re ne Shtepine e Bardhe, ka firmosur mbylljen e burgut famekq te Guantanamo ne nje baze amerikane ne Kube, burg qe i ka fillimet e tij me ardhjen ne pushtet te administrates se ish-presidentit Bush. Ky burg u be simboli i nje padrejtesie qe shkelte ne menyre te hapur te drejtat me elementare te burgosurve duke i lene ata me vite te tera pa i gjykuar dhe duke bere qe ata t'u nenshtrohen torturave shume te ashpra me motivin se ato duhen te torturohen per te nxerre informata qe forcojne sigurine e SHBA. Kushtet e renda, krahas torturave, i detyruan disa te burgosur qe te vetvriteshin duke bere qe protestat te perhapeshin ne te gjithë boten, ku protestuesit kerkonin qe ky burg te mbyllet. Edhe ne SHBA u rrit zemerimi kunder ketij burgju dhe atyre qe e hapen

dhe po e mbanin perseri te hapur, duke prishur imazhin e amerikaneve neper te gjithë boten. Kjo ishte arsyeja perse Barak Obama u pat premtuar amerikaneve ne fushaten elektorale se ai, ne se zgjedhje president, do ta mbyllte Guantanamo. Duket se Obama po e mban fjalen, pasi tashme afati kohor per ta mbyllur eshte perkaktuar dhe firma e presidentit eshte hedhur ne leter per mbylljen e tij. Nje vit nuk eshte shume kohe per ta boshatisur burgun, ku te burgosur jane te gjithë muslimane dhe mbahen aty pa fakte dhe pa argumenta qe t'i fajesonin per krime. Guantanamo ishte bere burg vetem per muslimane, sepse duket se te tjere aty nuk ka duke krijuar ne opinjonin publik nderkombetar nje simbioze shume te rrezikshme e cila eshte "muslimanet dhe terroristet jane nje" Presidenti Obama do t'i mbetet merita qe i vuri celesin Guantanamo dhe i la muslimanet te lire. Por,






merita e vertete u takon atyre qe e penalizuan politikisht ate qe u be ne Guantanamo, duke bere qe bota te shokohet nga shkelja e ligjeve amerikane dhe nderkombetare ne trajtimin e te burgosurve. Pamjet qe u ndoqen permes medive ne shume raste nuk mund te harrohen aq lehte. Aty ishin burgosur edhe femije 14 vjecare te cilet u rriten ne Guantanamo qe ishte nje ferr i vertete per te gjithë ata qe e provuan Guantanamo. Flitet per 300 te burgosur te cilet jane te gjithë muslimane. Flitet per ushtarë amerikane qe u vendosen te burgosurve librin e shenjtes Kuranit neper banjo si leter higjenike, duke treguar se trajtimi i te burgosurve kishte edhe urrejtje fetare. Burgu do te mbyllet dhe ata qe e hapen dhe e mbajten te hapur ne me pak se nje dekatë duket se do te dalin te lare dhe pa pergjegjesi per ate qe ndodhi ne Guantanamo. Por, mbyllja e ketij burgju famekq nuk do te

jete i mjaftueshem per te mbyllur plaget e atyre qe vuajten ne qelile e tij ku humben vite jete dhe provuan tortura te renda. Ai do te jete i pamjaftueshem edhe per te mbyllur plagen qe i la pas drejtësisë amerikane tek e cila ka besim sot bota e qytetëruar qe po ballafaqohet me dy standarte ne vleresimin e ngjarjeve, religjoneve dhe personazheve politike, duke i bere njerezit dhe shtete te tera qe te jene te frikesuar dhe te pasigurte perballe ketyre standarteve, ku ligjin duket se e bejne qendra misterioze nderkombetare te cilave nuk u shihet pamja por u shihen vetem bemat e tyre. Dhe jane pikerisht ata qe nderzin zjarre te cilet rrezikojne te nderzin Zjarrin e Madh i cili nuk do te fale as ata qe mendojne se kane imunitet per te shpetuar nga Zjarri i Madh.

Informacion mediatik

PROGRESI

BOTIME



Adresa Shqipëri
L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi / Shkodër
Tel: +355 69 20 76768 / +355 67 20 86767
e-mail: revistaetika@hotmail.com

Adresa Kosovë
Ardian Zurnaciu / Marash / Prizren
Tel: +377 44 337582
e-mail: orhan_s22@hotmail.com

Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme
**MISH
HALLALL**

E XHUMA
PUSHIM → BESNIK ALUSHI
ISMETI

Produkt Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.**

2- Piceri hallall

3- Fast Food hallall

**Ju keni të drejte të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893